



UDHËZIM

M=3749/1

CR 3.4.15

Nr 12, datë 3.9.2015

**“PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.25, DATË 30.11.2007
PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E
INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË
DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË
KËMBIMIT TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 me propozimin e Komisionit ad-hoc, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në Udhëzimin nr. 25 datë 30.11.2007, në sesionin II: Burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, pika 10.1 zëvendësohet me fjalinë e më poshtme:
10.1 Çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të marra nga Agjencia “Thompson Reuters” PLATTS. Informimi për të dhënat e marra nga këto agjenci, të bëhet drejtpërsëdrejti nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SHKËLQIM CANI
MINISTËR I FINANCAVE